

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër B.N., K.M. dhe N.V., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autoritetit zyrtar nga neni 442 par.1 lidhur me nenin 31 i KPRK-së dhe Xh.S., për shkak të veprës penale mashtrimi në subvencione nga neni 366 par.3 të KPRK-së, duke vendosur, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shtetit i Kosovës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.28/2017 të datës 18.10.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.573/2017 të datës 17.01.2018, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datë 14.05.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Pranohet si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, **konstatohet** se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.28/2017 të datës 18.10.2017 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.573/2017 të datës 17.01.2018, është shkelur dispozita e nenit 385 par.1 nënpar.1.4 të KPPK-së, në favor të të pandehurve B.N., K.M., N.V. dhe Xh.S..

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.28/2017 të datës 18.10.2017, i ka liruar nga akuza B.N., K.M. dhe N.V, për veprën penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autoritetit zyrtar nga neni 442 par.1 lidhur me nenin 31 i KPRK-së dhe Xh.S., për veprën penale mashtrimi në subvencione nga neni 366 par.3 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës penale janë përcaktuar që të paguhen nga mjetet buxhetore të

gjykatës, kurse përfaqësuesi i të dëmtuarës është udhëzuar që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

### **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.573/2017 të datës 17.01.2018, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

### **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka paraqitur Prokurori i Shtetit, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj kërkesën si të bazuar dhe të konstatoj se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

### **Mendimi i mbrojtësve të të pandehurve**

Mendim përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të pandehurës K.M. av. A.Q., me parashtresën e datës 26.03.2018, ka propozuar, që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të hudhet si e palejuar apo të refuzohet si e pabazuar;

- mbrojtësi i të pandehurit Xh.S. av. Y.H., me parashtresën e datës 26.03.2018, ka propozuar, që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të hudhet si e palejuar.

### **Pretendimet e paraqitura në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, theksohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale meqë me asnjë provë nuk është vërtetuar e kundërta e asaj që ka përmbajtur aktakuza përkitazi me veprimet inkriminuese të të pandehurve, që të njëjtit të lirohen nga akuza. Se të pandehurit kanë kryer veprën penale vërtetohen nga provat e tjera e po ashtu mbrojtja e të pandehurit Xh.S. të dhënë

me datën 13.01.2017 në prezencën e mbrojtësit të tij. Me këtë rast ai ka deklaruar se “...nuk i ka plotësuar kriteret por është përzgjedhur nga komisioni” e që kjo mbrojtje është në përputhje të plotë me provat materiale që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu që arsyetimin e aktgjykimit e bëjnë të jetë në kundërshtim me provat materiale të cilat e vërtetojnë fajësinë e të pandehurve.

Provat materiale vërtetojnë se i pandehuri Xh.S. dhe kompania e tij, nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për përfitimin e grantit në shumë prej 2.....,00 € nga Ministria e Bujqësisë, meqë për kompaninë e tij “C...” SHPK ka paraqitur certifikatën e biznesit kinse është për subjektin industria e mishit “C...” duke paraqitur të dhëna fiktive për numrin e punëtorëve që kanë punuar në ndërmarrjen tjetër “G...” me qëllim të përfitimit të poenave për të fituar grantin. Nga provat materiale është vërtetuar se “C... SHPK” është biznes i veçantë dhe mban numrin e regjistrimit ....., me nr.fiskal ....., ndërsa subjekti I... “C...SHPK” është biznes i veçantë dhe mban numrin e biznesit .... me nr.fiskal .....-V., pra është fjala për dy biznese të veçanta.

Përmes dëshmisë së dëshmitarit R.R., është vërtetuar se në kohën e aplikimit për grant firma C., nuk i ka pasur dy vjet përvojë siç ishte përcaktuar në kriteret për fitimin e granteve. Po ashtu me rastin e aplikimit për grant është shënuar e dhënë e pasaktë se në industrinë e mishit kanë punuar 36 punëtorë për të cilët janë prezantuar edhe kontrata të punës se kinse punojnë aty e që pas verifikimit të komisionit është vërtetuar se këta punëtorë nuk punojnë në industrinë e mishit por në G.. dhe P.. restaurant. Ashtu që pronari i kësaj kompanie - i pandehuri Xh.S. ka paraqitur dokumentacion joadekuat me qëllim të përfitimit të grantit të Ministrisë së Bujqësisë.

Po ashtu provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë vërtetuar se edhe të pandehurit B.N., K.M. dhe N.V., kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autoritetit zyrtar nga neni 442 par.1 lidhur me nenin 31 i KPRK-së, meqë në cilësi të personave zyrtar kanë tejkaluar kompetencat e tyre zyrtare duke mos iu përmbajtur udhëzimit administrativ 01/2015, e që bazuar në këtë udhëzim subjekti në fjalë nuk kishte plotësuar kushtet për fitimin e grantit, ashtu që ia kanë mundur përfitimin material të kundërligjshëm përkatësisht përfitimin e grantit në shumë prej .....€, pasi që ka paraqitur të dhënat e pasakta në formularin për aplikim për fitimin e grantit.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale pos me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, po ashtu të njëjtat shkelje janë bërë edhe nga gjykata e shkallës së dytë e cila ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka paraqitur për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, mirëpo bazuar në referatin e kërkesës së paraqitur rezulton se kërkesa ka të bëjë me shkeljen e ligjit penal sipas dispozitës së nenit 385 par.1 nënpar.1.4 të KPPK-së. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje të ligjit penal sipas dispozitës së nenit 385 par.1 nënpar.1.4 të KPPK-së, përkatësisht ndaj të pandehurve B.N., K.M., N.V. dhe Xh.S., është marrë aktgjykim lirues, në kundërshtim me dispozitën e lartcekur, sepse është aplikuar ligji i cili nuk ka mundur të aplikohet.

Gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e saj e bazon në faktin se i pandehuri Xh.S., me rastin e aplikimit për grantin e Ministrisë së Bujqësisë nuk ka paraqitur të dhëna të pasakta, meqë bazuar në certifikatën e regjistrimit të biznesit nr. ... dhe numrit fiskal ..... “C. SHPK”, ka poseduar licencë valide për zhvillimin e veprimtarisë për prodhimin, përpunimin dhe konservimin e mishit, e cila veprimtari është e shënuar me shifrën 1511.

Mirëpo sipas udhëzuesit për aplikant “M...103” të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, janë specifikuar kriteret për përfitimin e grantit. Është specifikuar se për sektorët e përpunimit të qumështit dhe mishit se *“Përfitues të mundshëm janë subjektet të cilët kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në sektorin përkatës për së paku dy vjet para datës së aplikimit”* (faqe 9 e udhëzuesit), e të cilin kriter nuk e kishte plotësuar “C...SHPK”, meqë asnjëherë nuk ishte marrë me aktivitet për përpunimin e mishit dhe produkteve të tij, e këtë e pohon edhe vet aplikuesi përkatësisht i pandehuri Xh.S., duke pohuar se asnjëherë nuk ka zhvilluar veprimtari të përpunimit të mishit. Po ashtu nuk i ka plotësuar kriteret për marrjen e

grantit, siç ka deklaruar gjatë mbrojtjes së tij me datë 13.01.2017 në prezencë të mbrojtësit të tij e të cilën mbrojtje e mohon gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 27.09.2017, siç pohon se “*Është i vërtetë deklarimi i tij, mirëpo arsyetohet se gjatë kësaj kohe nuk ka qenë në gjendje të mirë psiqike*” (faqe 12 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 27.09.2017).

Se aplikimi përmbante të dhëna të rrejshme vërtetohet edhe përmes faktit se vetëm për qëllim të aplikimit për grantin në fjalë ishin përpiluar kontrata fiktive për 36 punëtorë se kinse të njëjtit kanë filluar me punë në “I... C... SHPK” me datë 01.01.2015 edhe pse kjo industri nuk merrej fare me përpunimin e produkteve të mishit.

Gjykata e shkallës së parë e të cilin arsyetim e ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë, gabimisht ka gjetur se “C...SHPK” i ka plotësuar kushtet për aplikim pasi që arsyetimi është bazuar në certifikatën e regjistrimit .... dhe certifikatën e numrit fiskal ...., mes tjerash ka licencë në numrin ...., me veprimtari prodhimi, përpunimi dhe konservimi i mishit. Mirëpo ky fakt është irrelevant pasi që sipas udhëzuesit përfitues të mundshëm janë subjektet të cilët kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në sektorin përkatës për së paku dy vjet para datës së aplikimit e që mund të konkludohet se subjekti “I... C...SHPK” fare nuk ka zhvilluar aktivitet për prodhimin dhe përpunimin e produkteve të mishit.

Përkitazi me të pandehurit B.N., K.M. dhe N.V., gjithashtu gabimisht është konstatuar se në veprimet e tyre nuk janë manifestuar elementet e veprës penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autoritetit zyrtar nga neni 442 par.1 lidhur me nenin 31 i KPRK-së, pasi që të njëjtit gjatë shqyrtimit të aplikacionit për aplikuesin “C... SHPK”, në cilësinë e personave zyrtar për vlerësim dhe miratim të projekteve në AZHB-së- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kanë tejkalluar kompetencat zyrtare duke mos iu përmbajtur udhëzimit 01/15 për vlerësimin dhe miratimin e dokumentacionit për firmën “I... C...SHPK” në Gjilan, nuk kanë respektuar udhëzuesin për “Masa ...”, pasi që kjo firmë para datës së aplikimit nuk kishte pasur përvojë dy vjeçare në lëminë e përpunimit të produkteve të mishit ashtu që përfituar grantin në shumë prej ..... € e nga të cilat e ka përfituar shumën prej ..... €.

Të pandehurit nuk iu kanë përmbajtur udhëzuesit përkitazi me përvojën e punës në lëminë e përpunimit të produkteve të mishit dhe me këtë rast të pandehurit B.N., K.M., kanë shqyrtuar dokumentacionin e aplikuesit dhe me këtë rast përkitazi me përvojën e firmës “I... C...

SHPK” në Gjilan, e kanë poentuar 10 pikë edhe pse nuk ka pas përvojën dy vjeçare në përpunimin e mishit siç ishte specifikuar në udhëzim, kurse i pandehuri i tretë N.V., gjithashtu ka nënshkruar raportin dhe përmes kësaj aplikuesi ka marrë grantin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në shumë prej ... € e nga të cilat e ka përfituar shumën prej ... €.

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë, u vërtetua se janë shkelur dispozitat e ligjit penal në favor të të pandehurve dhe kjo Gjykatë vetëm e konstaton këtë shkelje, duke mos e prekur vendimin e formës së prerë në raport me të pandehurit.

Nga arsyet e cekura, konform dispozitës së nenit 438 par. 2 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.99/2018, më datë 14.05.2018

Bashkëpunëtori profesional,  
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka